

Emri nga sistemi : ALBANIAN FURNITURE OFFICE SHPK

NIPT : M32303056L

Tirane

Pasqyrat financiare të vitit 2024

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE 2024

Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare 2024 për Shoqërinë ALBANIAN FURNITURE OFFICE SHPK japin informacion shtesë, bazuar në kërkesat e Standartit Kombëtar Kontabilitetit Nr.2, të përmirësuar. Shpjegimet e dhëna në këto shënime, ndjekin renditjen si më poshtë :

I. Informacion i përgjithshëm :

Evidenca kontabile dhe plotësimi i Pasqyrave Financiare të vitit 2024 pershkohen nga ligjshmeria dhe profesionalizmi duke u bazuar teresisht ne nje kuader ligjor kushtet meposhteme :

- 1.Kuadri ligjor i zbatuar : Ligji 25/2018 dt.10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"
- 2.Kuadri kontabël ligjor i aplikuar : Standarti Kombëtar i Kontabilitetit Nr.2, i përmirësuar.
- 3.Koncepti bazë : PF janë përgatitur mbi bazën e konceptit të materialitetit (Paragrafi 70-76 i Standartit) për PF.

•**Parimi i Njesisë Ekonomike** : dmth se Kompania jonë A.F.O Shpk, i mban llogaritë e Aktiveve, të transaksioneve të veta, të veçanta nga ato të pronarëve, kreditorëve, punonjësve, klientëve si dhe për - sonave të tjerë.

•**Parimi i vijimësisë** : PF janë përgatitur sipas këtij parimi, që do të thotë se veprimtaria e kompanisë ka vazhdimësi dhe do të ketë vazhdimësi të veprimtarisë së saj tregtare dhe se nuk ka plan për të ndërprerë aktivitetin e saj. Gjate viti 2024 Ajo ka patur nje rritje te ndieshme te volumit tregtar, te shitjeve, duke e cuar ate ne afro 14.000.000 leke, por akoma nuk ka dale nga humbja, vazhdon edhe kete vit aktivitet me humbje, biles mund te thuhet se eshte 3 fishuar kjo humbje.

•**Parimi i kompensimit ose moskompensimit**: Do të thotë se gjatë përpilimit të PF detyrimet dhe të Ardhurat e shpenzimet nuk kompensohen me njëra tjetrën. Nuk mund të ketë dhe nuk ka raste të tilla kontabilizimi në këtë shoqëri.

•**Parimi i kuptueshmërisë, informacioni** i dhënë në këto Pasqyra është përgatitur i tillë, që të jetë i kuptueshëm për përdoruesit e tyre.

Shënimet për PF japin shpjegime për pozicionin Financiar të llogarive, për performancën e Shoqërisë A.F.O. Shpk, fluksin monetar dhe gjendjen e lëvizjen e Kapitalit, të mbrojtur nga gabimet materiale dhe paragjykimet si dhe ndihmon Drejtuesit e saj të marrin vendimet e duhura për mbarrëvajtjen sa më të mirë të aktivitetit. Mbi këtë bazë janë zbatuar edhe parime të tjera të domosdoshme gjatë aktivitetit dhe për përpilimin e PF si :

- 1.Parimi i paraqitjes me besnikëri i PF
- 2.Parimi i përparësisë së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore;
- 3.Parimi i paanëshmërisë ;
- 4.Parimi i maturisë ;
- 5.Parimi i plotësisë ;
- 6.Parimi i qëndrueshmërisë dhe krahasueshmërisë

II. Politikat Kontabël

Në përpilimin e PF nuk ka ndryshime të politikave kontabile, Kompania ALBANIAN FURNITURE OFFICE Shpk, është një kompani relativisht e re. Ajo nisi aktivitetin në Tetor 2023 dhe Viti 2024 është viti i parë i plotë në aktivitetin e saj dhe ekziston besimi për vazhdimësinë dhe optimizmi në arritje të vlerës.



[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

tateve me te mira në fushën e veprimtarisë tregtare që ajo zhvillon e do të zhvillojë në të ardhmen. Shoqëria pasqyron saktë gjendjen dhe lëvizjen e stokut. Vlerësimin e stokut ajo e bën të bazuar në çmimin e blerjes plus shpenzimet e transportit dhe magazinimit. Në rastet e importit, çmimit të blerjes i shtohen përveç atyre më lart edhe shpenzimet doganore. Në çmimin e shitjes vec kosos së blerjes i shtohen dhe 15-20% marzh fitimi dhe shpenzimet e shitjes. Në raste shumë të rralla, kur rrezikohet zhvlerësimi i stokut dhe prishja e tij Drejtimi mund të marrë vendime për uljen e çmimit të shitjes në kosto ose nën kosto. Kjo politikë nuk do të ndryshojë, ajo do të vazhdojë vit pas viti, të pakten deri në 5 vjet..

Edhe për Aktivet afat gjata materiale, pavarësisht se nuk ka aktualisht, por kur të blihen ato, do të zbatohen të njëjtat politika kontabile. Njohja dhe gjendja e tyre do të bëhet me çmimin e blerjes plus koston e transportit etj dhe zhvlerësuar me amortizimin vjetor. Pra në fillim ato do të njihen dhe pasqyrohen me vlerën fillestare dhe pastaj do të zhvlerësohen çdo vit me amortizimin e tyre në % e përcaktuar me Udhëzimin të Min. Financave Nr. 26 dt.08.09.2023 me ndryshimet sipas Udhëzimit nr.4 dt. 04.02.2025.

Si kufinj fiskale jone : ndërtesat me 0.5%, pajisjet, mobilje e orendi, mjete transporti me 20% dhe pajisjet kompiuterike me 25%. Gjatë vitit 2023 (pra 2 muaj aktivitet : Nëntor - Dhjetor) dhe 2024 nuk ka patur blerje Asetesh. Metoda e llogaritjes së Amortizimit ka ndryshuar sipas Udhëzimit - tani do të bëhet me metoden lineare dhe do të merret si vlerë fillestare vlera e mbetur me 31.12.2023. Një ndryshim tjetër ka të bëjë me kufirin fiskal të llogaritjes së Amortizimit për autoveturat 1+4 të personelit i cili nuk mund të jetë me i lartë se 50% e kostove të blerjes dhe rikonstruksionit, përfshirë dhe tvsh-ne. Në Udhëzim është përcaktuar se kostoja e plote e autovetures 1+4 e cila amortizohet 50% nuk mund të jetë me e lartë se 10.000.000 leke.

Politikat e njohjes dhe evidentimit të arkëtive dhe detyrimeve të arkëtueshme nuk do të ndryshojnë. Ato do të njihen mbi bazën e një dokumenti që është fatura e shitjes apo ajo e blerjes, ose sipas përcaktimit të kontratave të ndryshme të firmosura nga palët.

Në politiken e mbartjes së humbjeve nga veprimtaria ekonomike do të ndiqet politika e përcaktuar në Udhëzim, që Humbja që rezulton në një vit të caktuar tatimor kompensohet me fitimet e 5 viteve të ardhme të timore.

III. Shënime për zëra të veçantë të PF

A Aktivet e Pasqyrave Financiare

Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, Mjetet monetare gjendje në kompani në mbyllje të vitit 2024 në bankë dhe arkë janë në shumën **427.819 lekë**. Ato paraqiten si më poshtë :

Nr.	Banka ose Arka	Mon	Sasia	K.k.v	Σ Lekë
1	RFZ Banke	Lekë	0	0	9,453
2	RFZ Banke	Euro	2,351	98.15	230,702
3	Arka Cash	Lekë	0		187,664
4	Arka Cash	Euro	0	98.15	-
	Shuma				427,819

Në "Të drejta të Arkëtueshme" paraqiten gjendjet e llogarive për shumën gjithsej : **9.608.354 lekë**, si më poshtë :

1 Nga "Aktiviteti i shfrytëzimit"(Llog.411."Klientë") paraqitet në shumën **8.884.339 lekë**

Për llogarinë e Klientëve disponohet Inventari kontabël i Klientëve dhe Kartelat analitike të tyre. Detyrimet e tyre janë normalisht në arkëtim e sipër dhe brenda 3 muajve të 1-rë të vitit 2025 ato arkëtohen totalisht. Sipas inventarit kontabel të tyre Klientët janë :

1	411.0016.Tirana Internacional Airoport	EU	730	71,650
2	4110023 RO-AL Shpk	Leke		2,712,730
3	4110035 Aliu Road House	EU	140	13,740
4	4110044 Xhelips	Leke		1,500,000



5	4110050 M.Lezha	"	3,500,000
6	4110051 AK Green Konstruktion	"	1,082,854
7	4110019 Zyra Permbarimit	"	3,665

Shuma 8,884,639

II Në "Të tjera të arkëtueshme" paraqiten gjendje 3 llogari, në shumën **724,015 lekë** :

a). **455. "Detyrim i Ortakut"** për kapitalin e pa derdhur në shumën**180.400 lekë**;

b). **445.6 "Tvsh e zbritëshme"**, në shumën.....**543.615 lekë**;

Sic duket Detyrimi i Ortakut ka mbetur pa u mbyllur dhe detyrimisht duhet të mbyllet brenda vitit 2025, ndërsa Tvsh e zbritëshme prej 543.615 leke do të mbyllet gradualisht me shitjen e mallrave gjendje në magazinë gjatë ushtrimit të aktivitetit 2025. Tek llogaritë e **Inventarëve** paraqitet gjendje vetëm një llogari, ajo e mallrave për shitje, në shumën sipas inventarit kontabël dhe atij fizik prej **6.169.355 lekë**.

Ekziston inventari fizik i mallrave, i cili është perputhur plotësisht me atë kontabel.

Në llogarinë e **"Aktiveve Afat gjata Materiale"** nuk paraqitet gjendje sepse nuk ka blerje të tyre e- dhe gjate vitit 2024.

B Detyrimet në Pasqyrat Financiare ;

1). Në Detyrimet që ka shoqëria peshën më të madhe e zënë **"Të pagueshmet për aktivitetin e shfrytëzimit"** që janë detyrimet ndaj Furnitorëve. Ato zënë shumën prej **11.194.466 lekë**.

Detyrimin më të madh Shoqëria e ka ndaj Kompanisë "RO-AL" SHPK. Detyrimi ndaj saj paraqitet në shumën **11.134.154 lekë**. Detyrimet ndaj Furnitorëve të tjerë janë shume te vogla dhe likuidohen brenda muajit Janar 2025 : ndaj "Albsig" shumen 24.3331 leke dhe ndaj QSK "ULJORD-2012" shume 36.000 lektë. Eshte detyre e kompanise te filloje likuidimin e faturave te "RO-AL" sapo te krijohet aftesa paguese nepemjet shitjeve qe do te realizohen gjate vitit 2025.

Shoqëria disponon inventarin kontabël të Furnitorëve, kartelat analitike të tyre të cilat rakordojnë me llogarinë sintetike të Furnitorëve sipas faturave me nr. e date.

2). Detyrimi tjetër i Shoqërisë është pasqyruar në emertimin **"Të pagueshme ndaj punonjësve"** në shumën gjithsej prej **695.612 lekë** dhe që u përket pagave të punonjësve sipas liste pageses te pa paguara brenda vitit 2024 dhe qe likuidohen brenda Janarit 2025.

3). **Detyrimet ndaj shtetit** përbëjnë rubrikën e tretë të Detyrimeve të Shoqërisë. Në PF të vitit 2024 paraqiten detyrimet ndaj shtetit në shifrat e mëposhtme :

a). Detyrimet për Kontributet e sig. shoq. & shënd dhe Tap jane në shumën **155.519 lekë**, per-katesisht per kontributet me detyrim 147,329 leke dhe Tap-n me detyrim 9.180 leke Detyrimi likuidohet brenda dt.20 Janar 2025

C Për levizjen dhe gjendjen e Kapitalit te shoqërisë

Kapitali i Shoqërisë A.F.O. Shpk paraqitet ne Pasqyrën e Lëvizjes dhe gjendjes së Kapitalit neto per vitin 2024 dhe rezulton si me poshte :

a). **Kapital i nënshkruar gjithsej në shumën.....2.120.000 lekë**;

• Nga ky i paguar në bankë.....1.939.600 lekë;

• Mbetet për t'u derdhur brenda vitit 2025.....180.400 lekë.

b). **Humbja e mbartur e vitit 2023.....-1.075.333 lekë**.

c). **Humbja e vitit ushtrimor 2024.....-3.274.437 lekë**.

Humbja e realizuar ne shumen **-3.274.437 leke** ka sjellë si pasojë zvogëlimin e Kapitalit neto ne nivele **aktuale** ma me te uleta nga 1.044.657 leke që ishte në fillim të vitit 2024 ne-2.229.779 leke në fund të ketij viti.

Mbetet detyrë kryesore rritja e volumit të shitjeve gjatë vitit 2025, për të rritur të ardhurat, fitimin dhe per rritjen e kapitalit e te burimeve te veta.

D Realizimi i Performancës së shoqërisë për vitin 2024

Gjatë vitit 2024 Shoqëria "Albanian Furniture Office" Shpk nuk doli dot nga aktiviteti me humbje, realizoi

Gjatë vitit 2024 Shoqëria "Albanian Furniture Office" Shpk nuk doli dot nga aktiviteti me humbje, realizoi një humbje sic u evidentua me lart tek pershkrimi I Kapitalit ne shumen -3.274.437 leke. Kështu qe vlere-simi per performancen e aktivitetit ekonomik mbetet "I dobet". Treguesit Kryesorë financiarë u realizuan si më poshtë :

I Të Ardhurat gjithsej u realizuan në shumën	13,731,118 lekë;
II Shpenzimet gjithsej u realizuan në shumën.....	(17,005,555) lekë;
III Humbja e realizuar.....	(3,274,437) lekë;

I Te Ardhurat

Nga analiza e realizimit e të Ardhurave evidentohet si me poshte:

Të Ardhurat për 2024 janë realizuar :

a). Nga shitjet e mallrave	13,717,399 lekë
b). Të Ardhura të tjera janë realizuar.	13,719
Shuma	13,731,118

Duke pare Te Ardhurat sipas Formulave te Deklarimit dhe Pageses mujore të Tvsh të deklaruar në Ta-time të Ardhurat nga shitjet janë realizuar në shumën 13.717,399 lekë, ndërsa në këto PF ato janë shënuar në shumën 13.731.118 lekë, pra me një difference prej 13.719 leke shume kjo e ardhur nga kembimet valutore, ndersa per te ardhurat nga shitjet ka nje perputhje te plote midis tyre.

Duke pare nivelin e Shpenzimeve te cilat per vitin 2024 ja-ne nje raport te zhdrejte, rreth 20 % me te larta eshte teper e domosdoshme qe te rriten shitjet nepermjet zgjerimet te tregut, shtimit te artikujve per shitje dhe rritjes se efektivitetit te shpenzimeve.

2 Shpenzimet

Sipas elementëve shpenzimet paraqiten si më poshtë :

Nr	Nr Llog	E m e r t i m i	Shuma Lek
I		Shpenzimet per Personelin Punonjes	
1	641	Shpenzimet per Pagat e Punonjesve	5,591,054
2	644	Shpenzimet per Sigurimet shoq. & shëndets.	940,360
		Shuma I	6,531,414
II		Shpenzime jo me Fatura (me dokumenta te tjera)	
1	628	Shpenzime për komisione bankare	8,799
2	634	Shpenzime për taksa e tarifa lokale (Bashkise Tirane)	44,333
3	657	Shpenzime per kamate vonesa	2,341
4	669	Shpenzime nga kembimet valutore	49,060
		Shuma II	104,533
III	60	Shpenzime të bëra nga blerjet (me fatura)	
1	605	Blerje mallra (mobilerie etj.) për shitje	9,936,024
2	616	Shpenzime për sigurime -garanci ofertash	68,761
3	618.1	Shpenzime për sherbime te jashtme kontabiliteti & fiskale	270,000
4	618.2	Shpenzime për blerjen vjetore te programit AlphaWeb	87,000
5	618.3	Shpenzime për sherbime te tjera	7,823
		Shuma III	10,369,608
		Shuma e shpenzimeve pa Pagat e Sigurimet	10,474,141
		Totali Shpenzimeve	17,005,555

Saktesia e te dhenave per Shpenzimet ne PF, ne Pasqyren e Performances (sipas natyres) e cila sic vërtetohet me poshte ne analize rakordon me vleftat e FDP të deklaruar ne e-Filling gjate vitit 2024 :

Kjo Pasqyrë bën krahasimin e shpenzimeve për blerjet të deklaruar sipas FDP në sistemin e-Filling me ato të deklaruar në PASH në Pasqyrat Financiare dhe në Deklaratën vjetore të Tatimit mbi Fitimin për vitin e mbyllur 2024 dhe rezultoni :

Nr	E m e r t i m i	Shuma Lek
I	SIPAS FDP TE DEKLARUARA NE e-Filling	
	(Vetem per Blerjet)	
1	Shpenz.për blerje mallra nga importi pa tvsh (imp.7)	-
2	Shpenz.për blerje mallra nga vendi pa tvsh	68,781
3	Shpenz.për blerje mallra nga importi me tvsh (imp.4)	-
4	Shpenz.për blerje investimi nga importi me tvsh (imp.4)	-
5	Shpenz.për blerje mallra nga vendi me tvsh	7,369,784
6	Shpenz.për blerje investime nga vendi me tvsh	-
	Shuma	7,438,565
	Nga kjo shumë zbritet :	
1	Blerjet per Investime	-
2	Pakesimi i gjendjes se inventarit (stokut) ne magazine	2,931,043
	Shuma	2,931,043
	Mbeten Shpenzime Blerje per mallra e sherbime	10,369,608 ok
II	SIPAS PF e Deklarates Vjetore te Tatim Fitimit	
	(Vetem per Blerjet)	
1	Gjithsej Shpenzimet e vitit 2024	17,005,555
	Nga kjo shumë zbritet :	
a	Shpenzimet për personelin (Paga & Sigurime)	6,531,414
b	Shpenz.për bl. Sherbime jo me Fatura (me dok.te tjer)	104,533
	Shuma	6,635,947
	Mbeten Shpenzime Blerje per mallra e sherbime	10,369,608 ok

Pra Shpenzimet e kryera per blerje mallra e sherbime me dokumenta me te dy format e deklarimit në Tatime përputhet plotësisht me shifren **10.369.608 lek**. Duke i shtuar kësaj shume dhe **Shpenzimet per Pagat = 5.591.054 lek** dhe ato per **Kontributet sig shoq & shend. = 940360 lek** Shpenzimet gjithsej kapin vlefien prej 17.005.555 lek.

Per vitin 2025 krahas rritjes se te Ardhurave kerkohet nje ndjekje dhe analize me periodike dhe e - fikase per ti mbajtur ato nen kontroll te vazhdueshem.

Evidentojmë dhe nënvizojmë faktin se të gjitha veprimet ekonomike, kontabile dhe transaksionet financiare janë kryer me dokumenta të rregullta, çdo e ardhur dhe shpenzim për blerje është kryer me faturë të fiskalizuar.

III. Shënime te tjera shpjeguese të PF

1). Evidentohet fakti se në Shoqërinë Albanian Furniture Office nuk ka ndodhur ndonjë ngjarje pas datës së plotesimit të PF, për të cilat bëhen rregullime apo ngjarje të ndodhura pas datës bilancit për të cilat nuk behen rregullime kontabile.

2). Gjithashtu nuk kanë ndodhur gabime materiale në periudhën kontabël raportuese -2024 dhe qe duhen korigjuar ne PF te Shoqerise "Albanian Furniture Office Shpk.

Përpiluesi Pasqyrave Financiare

Q.S.K. "ULJORD-2012" Shpk

Jorgji Binjaku

ADMINISTRATORI

Eduard Përmeti



[Signature]

